


# EU4SAFEALB



## AKTIVITETET E PROJEKTTIT

Tenderi për sistemet e lëvizshme të mbikëqyrjes, oficinën e lëvizshme për mirëmbajtje dhe mjetet e lundrimit për patrullim u zhvillua gjatë periudhës shkurt-prill 2021. U shpallën kontratat fituese vetëm për lotet e prokurimit të sistemeve të lëvizshme të mbikëqyrjes dhe oficinës së lëvizshme për mirëmbajtje. Janë nënshkruar kontratat me kompanitë e përzgjedhura dhe parashikohet që dorëzimi të bëhet në dhjetor 2021. Megjithatë, gjatë dhe për shkak të implikimeve të krijuara pas COVID, furnizuesit njoftuan vonesa të mundshme për dorëzimin në tremujorin e parë të vitit 2022.

Tenderi për furnizimin me mjete lundrimi për patrullim u zhvillua gjithashtu me sukses. Komiteti i vlerësimit teknik vlerësoi ofertat gjatë periudhës shkurt dhe qershor 2021. Ofertuesi fitues për një mjet lundrimi për patrullim 15 m dhe katër 10 m të gjatë ka filluar prodhimin e mjeteve të lundrimit dhe dorëzimi i tyre në Shqipëri parashikohet të bëhet në mars 2022.



Për të shpallur tenderin për sistemin e radarëve për mbikëqyrjen e bregdetit, në mars 2021 ekipi i projektit zhvilloi një studim fizibiliteti për vendndodhjet e radarëve.

Ekipi i ekspertëve identifikoi vendndodhjen e radarëve si edhe punën e nevojshme për instalimin e radarëve në bregdet. Gjetjet e studimit të fizibilitetit shërbyen si bazë për përgatitjen e dosjes së tenderit për sistemin e radarëve për mbikëqyrjen e bregdetit, i cili u shpall në korrik 2021. Për shkak të kufizimeve buxhetore, vendimi u mor në konsultim me donatorin dhe përfituesin e instalimit të radarëve në Tale dhe Dhërmi.

Tenderi u zhvillua gjatë periudhës gusht-shtator 2021. Në lotin e parë, u identifikua kompania për ndërtimin e kullave të radarëve. Në lotin e dytë, komiteti i vlerësimit teknik nuk përzgjodhi ofertues për shkak të mospërputhjeve me specifikimin teknik dhe tenderi do të shpallet përsëri.

## TAKIM AD HOC I KOMITETIT DREJTUES TË PROJEKTTIT



Për të koordinuar hapat e radhës pas rezultatit të tenderit të parë për furnizimin me sistemeve të lëvizshme të mbikëqyrjes, oficinën e lëvizshme për mirëmbajtje dhe mjete lundrimi për patrullim, si edhe për të rëndë dakord mbi hapat e radhës në lidhje me sistemin e radarëve për mbikëqyrjen e bregdetit, më 6 maj 2021 u zhvillua një takim ad hoc i Komitetit Drejtues të Projektit me pjesëmarrjen e ekipit të projektit, donatorit dhe përfaqësuesve përfitues.

Komiteti Drejtues i Projektit mori vendim për përparësinë e sigurimit të sistemit të radarëve për mbikëqyrje mbi pajisjet e tjera të mbetura nga lista e prokurimit,

për ri-shpalljen e tenderit për prokurimin e mjeteve të lundrimit për patrullim si edhe për shkallën e fleksibilitetit në prokurimin e pjesëve rezervë për nevoja emergjente të Policisë Shqiptare të Kufirit dhe Migracionit (PKM).

### KOORDINIMI ME OFICERËT E NDËRLIDHJES LIOs SË SHTETEVE ANËTARE TË BE-së NË SHQIPËRI

Më 15 korrik, ekipi i projektit zhvilloi një takim koordinues me oficerët e ndërlidhjes të zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare të BE-së (LIOs) në Tiranë. Në takim morën pjesë LIOs nga Franca, Gjermania, Italia, Spanja dhe Zvicra. Ekipi i zbatimit të projektit informoi LIOs për statusin e projektit dhe rezultatet e pritshme dhe ndau listën e pajisjeve të blera në kuadër të projektit, deri tani. Takimi i koordinimit doli në konkluzionin që nuk ka mbivendosje të përpjekjeve dhe që ka mundësi për sinergji.

### PAJISJA E PKM ME MJETE LUNDRIMI PËR PATRULLIM DHE MJETE PATRULLIMI

Siç u identifikua gjatë vlerësimit të nevojave dhe boshllëqeve të PKM-së që u zhvillua në korrik 2020, mjetet e lundrimit për patrullim model FB të dhuruara nga BE në vitin 2011 kërkojnë riparim për të përmirësuar kapacitetin e tyre operacional. Për të identifikuar masën e riparimit, projekti rekrutoi një ekspert që po kryen një vlerësim teknik të statusit operacional të mjeteve të patrullimit. Vlerësimi i mësipërm i nevojave dhe boshllëqeve gjithashtu rekomandoi që të alokohet financim, në kuadër të projektit për të riparuar mjetet e patrullimit Land Rover që po përdoren nga PKM për mbikëqyrjen e kufirit të gjelbër. Ekipi i projektit rekrutoi një ekspert dhe filloi vlerësimin teknik të mjeteve të patrullimit Land Rover të PKM-së për të identifikuar përparësitë për riparim. Vlerësimi u krye gjatë periudhës shtator-tetor. Më tej projekti do të shpallë prokurimin e shërbimeve të riparimit të automjeteve me përparësi.

#### Kontakte

Z. Borut Eržen, Drejtues, Programi për Menaxhimin e Kufirit dhe Sigurinë, ICMPD  
Gonzagagasse 1, 1010 Vienna, Austria

Telefon: +43 1 504 4677 2357  
E-mail: [Borut.Erzen@icmpd.org](mailto: Borut.Erzen@icmpd.org)  
Faqe interneti: [www.icmpd.org](http://www.icmpd.org)

Të dyja këto aktivitete do të përmirësojnë kapacitetin operacional të PKM-së në përgjithësi duke zgjatur jetëgjatësinë e pajisjeve tashmë në dispozicion.

### VLERËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ASETEVE TË PKM-së

Ekipi i projektit kontrakttoi një ekspert për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të aseteve të PKM-së. Eksperti përgatiti pyetësonin për identifikimin e situatës aktuale në fushën e menaxhimit të aseteve dhe e ndau atë me përfituesit. Pasi mori reagimin e PKM-së, eksperti po harton rekomandimet për përmirësimin e kapacitetit të përgjithshëm të menaxhimit të aseteve të PKM-së. Pritet që bashkë me rekomandimet, eksperti të zhvillojë dhe të ofrojë trajnim për menaxhimin e aseteve për stafin përkatës të PKM-së.

#### Aktivitetet e planifikuara

- Dorëzimi i sistemit të lëvizshëm të mbikëqyrjes dhe oficinës së lëvizshme për mirëmbajtje
- Rishpallja e tenderit për prokurimin e radarëve të mbikëqyrjes së bregdetit
- Finalizimi i vlerësimit të sistemit të menaxhimit të aseteve të PKM-së, përmirësimin të kuadrit rregullator dhe trajnimit për menaxhimin e aseteve
- Prokurimi i pajisjeve të inspektimit të dokumenteve të udhëtimit, kompresorëve, pjesëve të këmbimit për kamerat termike
- Riparimi i mjeteve të lundrimit për patrullim, automjeteve të patrullimit dhe kamerave termike
- Riparimi i mjeteve të lundrimit për patrullim, automjeteve të patrullimit